



Rruga: "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë
Tel: +355 4226 8141
info@kmshc.al; kmshc@kmshc.al
www.kmshc.al



NËPUNËSIT CIVILË DHE SISTEMI I SHËRBIMIT CIVIL

Çfarë përfaqësojnë termat: nëpunës civil dhe sistemi i shërbimit civil?

Që një sistem qeverisjeje në një shoqëri të caktuar të realizojë me sukses zhvillimin e asaj shoqërie duhet të ketë një aparat shtetëror sa më të organizuar dhe efektiv. Ky aparat duhet të sigurojë rendin dhe sigurinë publike, të mbrojë jetën dhe pronën publike e private dhe të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Por, për funksionimin normal të këtij aparati shtetëror, veç organizimit të përsosur të tij, duhen edhe njerëz të përgatitur e të aftë.

Këta njerëz që punojnë në këtë aparat janë personeli i administratës publike, pa të cilët nuk mundet që shteti të përmbushë misionin e tij në shërbim të qytetarëve. Një pjesë e nëpunësve të administratës publike janë veçuar dhe janë evidentuar me termin: nëpunës civilë. Kjo kategori e administratës publike, funksionon brenda një numri të caktuar institucionesh dhe emërohet e ushtron aktivitetin e saj sipas disa rregullave të caktuara në mënyrë specifike, në zbatim të një ligji të veçantë. Pikërisht ky është edhe kuptimi i nocionit: sistemi i shërbimit civil.

Sistemi i shërbimit civil përfshin një tërësi institucionesh të administratës publike (*shtetërore, vendore dhe të pavarura*), që punësojnë nëpunës civilë, sipas disa rregullave të parashikuara në institute të ndryshme të një legjislacioni të posaçëm, i cili aktualisht përfaqësohet nga ligji nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe një sërë aktesh të tjera nënligjore, që rregullojnë aspekte të veçanta të administrimit të shërbimit civil.

Nëpunësit civilë, si përfaqësues të një kategorie që vlerësohet si elita e kësaj administrate, (*pasi kryejnë funksione kyç në aparatit e shtetit për ushtrimin e autoritetit administrativ, publik dhe realizojnë detyra që kërkojnë një nivel të lartë përgatitjeje profesionale dhe përgjegjshmërie qytetare*), e ushtrojnë aktivitetin e tyre në një marrëdhënie juridike specifike me shtetin, që quhet marrëdhënia e shërbimit civil, e cila rregullohet me një ligj të veçantë, ku parashikohen në mënyrë specifike, të drejtat dhe detyrimet e tyre, mënyra e rekrutimit, mobiliteti, masat disiplinore, si dhe aspekte të tjera të administrimit të marrëdhënies së tyre të punësimit, ndryshe nga pjesa tjetër e administratës, ku marrëdhënia e punës rregullohet nga Kodi i Punës i RSH.